

WRITERS ARE MASTERS OF THE WORD

Zarije Nuredini

State University of Tetovo - Tetovo, Republic of Macedonia, zarije.nuredini@unite.edu.mk
zarije_n@live.com

Through the written literature extensive readers learn about writers with rich lexicon of the Albanian folk language; they come across new words and expressions created by those writers, expand their vocabulary, and become owners of that discourse. The works of the most liked writers whose powerful words are of great importance to the written and spoken culture of a nation, affect the people in a significant way.

The paper aims to highlight the aesthetic function of language, to show the great expressive possibilities of Albanian language and the different shapes and shades it takes in artistic literature. Literary vocabulary is a permanent source of standard language not only in our language, but in all languages of the world.

When we say in linguistic terms, we consider the fund of special words that are being activated in a literary work, as well as the literary-stylistic hues that they take when they are used in some special cases, thus producing literary metaphors, for we know that language is the only means of creating literature and that without it we cannot think and talk about literature.

Keywords: linguistic achievements, artistic literature, literary-stylistic hues, literary metaphors, feelings and thoughts, masters of the word, phraseologisms.

SHKRIMTARËT JANË MJESHTRIT E FJALËS

Zarije Nuredini

UT-Tetovë, Republika e Maqedonisë, zarije.nuredini@unite.edu.mk zarije_n@live.com

Rezime: Nëpërmjet letërsisë së shkruar masat e gjera të lexuesve njohin shkrimtarë me pasurinë e leksikut të shqipes popullore, fjalë dhe shprehje të reja të krijuara prej shkrimtarëve dhe i bëjnë ato pronë të ligjërit të tyre. Në mënyrë të vecantë ndikojnë në popull veprat e shkrimtarëve më të pëlqyer, pesha e fjalës së të cilëve ndjehet e fuqishme në kulturën ligjërimore e shkrimore të popullit.

Punimi ka për qëllim të vëre në pah funksionin estetik të gjuhës, të tregojë mundësitë e mëdha shprehëse të gjuhës shqipe dhe format e nuancat e ndryshme që merr ajo në letërsinë artistike. Leksiku i letërsisë është ushqim i përhershëm i gjuhës standarde jo vetëm në gjuhën tonë, por në të gjitha gjuhët e botës.

Kur themi në aspektin gjuhësor, kemi parasysh, fondin e fjalëve të veçanta që aktivizohen në një vepër letrare, si dhe ngjyrimet letrare-stilistike që i marrin ato në raste të veçanta të përdorimit, duke prodhuar kështu metafora letrare, derisa e dimë se gjuha është mjeti i vetëm i krijimit të letërsisë dhe se pa të nuk mund të mendojmë e të flasim për letërsinë.

Fjalët kyçe: prurjet gjuhësore, letërsia artistike, ngjyrimet letrare-stilistike, metafora letrare, ndjenjat dhe mendimet, mjeshtrit e fjalës, frazeologizmat etj.

HYRJE

Punimi që po ju prezantojmë ka për qëllim të vëre në pah funksionin estetik të gjuhës, të tregojë mundësitë e mëdha shprehëse të gjuhës shqipe dhe format e nuancat e ndryshme që merr ajo në letërsinë artistike. Në të shtjelohen edhe prurjet e letërsisë në gjuhë. Kur themi prurjet e letërsisë artistike në gjuhë, rrezikojmë të tingëllojmë paradoksalë derisa e dimë se gjuha është mjeti i vetëm i krijimit të letërsisë dhe se pa të nuk mund të mendojmë e të flasim për letërsinë. Por, shikuar në sensin sociolinguistik të zhvillimit të gjuhëve përgjatë kohës, të humbjes së shprehjeve e fjalëve të ndryshme në periudha të caktuara historike, që herë zhduken apo zbehen me zhdukjen a plakjen e objektit që shenjojnë e herë për shkak të konsumimit të tepërt deri në trivializëm të një fjale a shprehjeje, mund të flasim për një proces të ushqyerit të gjuhës letrare me anë të letërsisë, pasi, sikurse dihet, letërsia kujdeset për një begati më të madhe gjuhësore dhe këtë jo rrallë e arrin duke aktivizuar fjalët e fondit rezervë të një gjuhe, fjalët e vjetëruara të saj, fjalët që janë përdorur në një epokë të caktuar dhe që lidhen me një fazë historike të kombit, fjalët e huazuara nga ndonjë gjuhë që dikur ka pasur dominim kulturor mbi kulturën tonë e që kahera janë lënë në harresë, kompozitat-metaforë që shpesh janë produkt i gjenialitetit krijues, fjalë të ndryshme burimore që i përkasin një zone të caktuar e që nuk janë përfshirë në fjalorin e gjuhës standarde etj.etj.

Shkrimtarët janë mjeshtrit e fjalës, ata e përpunojnë gjuhën e përbashkët kombëtare, gjuhën e popullit duke e ngritur atë në shkallë të lartë shpresie. Këtë e kishte parasysh gjuhëtari i shquar Aleksandër Xhuvani kur

shkruante: “Kudo, në çdo letërsi e në çdo kohë, shkrimtarët kanë qenë ata që i kanë dhënë hov përparimi gjuhës në veprat e tyre tue e lavrue e tue e pasunue”²¹⁷.

Shkrimtari, në krijimin e vet, jep ndjenjat dhe mendimet, përvojën shpirtërore, vëzhgimet nga shoqëria dhe natyra, bindjet dhe kërkimet, ëndrrat dhe idealet e tij, mirëpo për t’ia dhënë të gjitha këto lexuesit ai ka në dorë vetëm mjetet e gjuhës, fjalën shqipe. Kjo do të thotë se gjetja e fjalëve dhe e shprehjeve të goditura, e ndërtimeve sa më të përshtatshme, nuk arrihet lehtë; ajo është punë e gjatë që kërkon përgatitje të mirë kulturore e arsimore të shkrimtarit, kërkon njohje e përvojë jetësore, si dhe hulumtime e kërkime për të njohur pasurinë dhe mjetet shprehëse të gjuhës.

Këto marrëdhënie reciproke janë edhe qëllimi i këtij punimi që po prezantojmë pasi leksiku i letërsisë është ushqim i përhershëm i gjuhës standarde jo vetëm në gjuhën tonë, por në të gjitha gjuhët e botës. Shkrimtarë të mirë janë ata që e japin pasqyrën më të saktë e më të bukur të një gjuhe. Gramatikanët, përgjithësisht studiuesit e gjuhës, gjurmojnë, kodifikojnë, e përgjithësojnë praktikën e shkrimtarëve më të mirë të kombit. Këtë del se sa punë të madhe duhet të bëjnë shkrimtarët si për të zotëruar me themel pasurinë e mjeteve shprehëse, ashtu edhe për të fituar aftësinë që të nxjerrin prej fjalëve efekte të nevojshme artistike. Përmbajtja dhe kuptimi i fjalëve shfaqen në mënyrë të plotë vetëm atëherë kur njeriu i përdor ato në të shkruar ose në të folur. Ato gjallërohen kur bëhen mjet komunikimi, mjet shprehjeje e formësimi të veprave letrare artistike.

Letërsia ushtron ndikim të ndjeshëm gjuhësor në jetën e shoqërisë. Nëpërmjet letërsisë së shkruar masat e gjera të lexuesve njohin shkrimtarë me pasurinë e leksikut të shqipes popullore, me fjalë dhe shprehje të reja të krijuara prej shkrimtarëve dhe i bëjnë ato pronë të ligjërimit të tyre. Në mënyrë të veçantë ndikojnë në popull veprat e shkrimtarëve më të pëlqyer, pesha e fjalës së të cilëve ndjehet e fuqishme në kulturën ligjërimore e shkrimore të popullit. Të tillë peshë kanë pasur për shembull: Dante Aligieri, De Amicis për italishten; Moliere, Balzaku, Mopasani për frengjishten; Shekspiri, Dikensi, Thekërei, Gullsuorthi për anglishten; Gëta, Shileri, Hajne për gjermanishten; Pushkini, Gorki, Majakovski për rusishten etj.²¹⁸

Edhe shkrimtarët shqiptarë me artin e gjuhës së tyre e kanë ngritur gjuhën tonë letrare në shkallën e gjuhëve më të përparura të letërsisë botërore, e kanë bërë shqipen letrare të jetë shprehëse e saj, e kanë rritur në mënyrë të ndjeshme forcën dhe hijeshinë e saj. Në këtë punë me rëndësi të veçantë historiko-letrare kanë marrë pjesë disa breza shkrimtarësh. Në hullinë e mbarë të Naimit, Çajupit, Mjedës, Fishtës, Nolit, Migjenit, Komicës, Koliqit, Kutelit etj. ecën brezi i shkrimtarëve të sotëm. Fjala e poetëve, prozatorëve dhe dramaturgëve tanë më të mirë zë vend e ngulitet thellë në zemrat e mendjet e lexuesve, i pasuron dhe i fisnikëron ata, si dhe ua shton dashurinë për gjuhën amtare.

“Gjuha e letërsisë artistike përbën stilin a variantin më të gjerë e më të larmishëm të gjuhës sonë letrare kombëtare. Ajo ka gjithashtu mundësitë më të mëdha për të qëndruar fort në truallin e gjuhës popullore e për t’u ushqyer prej saj e njëkohësisht për t’u lidhur më ngushtë me traditën e gjuhës letrare, sepse në asnjë fushë gjallëria e forca e gjuhës letrare nuk është aq e fuqishme dhe jetëgjatë sa në letërsinë artistike”²¹⁹.

Sot letërsia shqiptare krijohet në rrethana të reja, kur kemi gjuhën standarde kombëtare, e cila po shkon drejt përpunimit e përsosjes së saj të mëtejshme. Kjo do të thotë se në traditën shkrimore shqiptare i gjithë visari gjuhësor i shqipes ka pësuar rivlerësim. Gjithçka që kishte krijuar populli ynë, qysh në kohët më të lashta të historisë së tij e deri në ditët tona, është bërë pasuri e përbashkët e krijuesve të sotëm shqiptarë, duke shembur çdo ndasi hapësinore e kohore, si dhe duke kapërcyer plotësisht ndonjë paragjykim krahinorist. Kjo pasuri është ngritur tashmë në shkallën e lartë të një norme të përpunuar e të ngulitur mirë. Shkrimtarët nga vise të ndryshme sjellin pasuri të çmueshme materialesh leksikore e gramatikore, nga të folmet e palëvruara ose pak të lëvruara letrarisht, që shërbejnë jo vetëm për formësimin e paraqitjes artistike të veprave të tyre, por edhe për begatimin e mëtejshëm të visarit kombëtar leksikor e frazeologjik të gjuhës shqipe. Mund të thuhet që nuk ka më zona që të mos përfaqësohen në letërsi me shkrimtarë që kanë dalë së andejmi.

Me zbatimin e gjerë të shqipes standarde në mbarë hapësirat e bashkësisë shqiptare u krijua një rrafsh i gjerë, i hapët, mbi të cilin mund të pranëvihen dhe të dallohen qartë veçoritë e gjuhës së gjallë të folur dhe krahinore, mjetet e vjetëruara dhe ato që sapo kanë nisur të mugullojnë. Kjo ka dhënë mundësi të pafundme që të sillen në letërsi edhe karakterizime e ngjyresa stilistike nga më të ndryshmet, duke u mbështetur në efektet që krijohen nga zgjedhja e mjeteve, nga shtresat e shumëllojshme leksiko-semantike e morfo-sintaksore të shqipes, duke u vënë ato në funksion e në shërbim të mëtimeve ideoartistike të autorëve. Tashmë mund të dallohet qartë gjuha e autorit nga ligjërimit i personazheve, gjuha e folur popullore nga ligjërimit libror apo nga trajta e folur e stileve të shkruara etj.

²¹⁷ Aleksandër Xhuvani, *Mbi thjeshtësinë e gjuhës shqipe*, “Norma letrare dhe kultura e gjuhës”, Tiranë, 1973

²¹⁸ A.Xhuvani, *Vepra*, vëll. I, 1980, f.33

²¹⁹ A.Kostallari, *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë* (referat), Tiranë, 1984, f.38

Synimi i parë i madh i çdo shkrimtari është bukuria e gjuhës, gjetja e fjalëve më të përshtatshme, e figurave më prekëse dhe më të vlefshme për përshkrimin e mjediseve ose për karakterizimin e personazhëve. Gjuha për shkrimtarin është si lënda drusore për zdrukthëtarin, si mermeri për skulptorin, si boja e peneli për piktorin. Të tillë e konsideronte shqipen Ernest Koliqi, një nga mjeshtret e mëdhenj të prozës shqiptare. Këtë bukuri të shqipes Koliqi e gjente në radhë të parë në traditën gojore, në gojën e njerëzve të thjeshtë e “të pandikuar” nga prishja të gjuhëve të huaja.

“Gjuha e jonë asht e bukur. Nuk e tham kët pse si Shqiptar më duhet me lavdue gjuhën shqipe, por pse jam i bindun qi kemi një gjuhë në vetvete të bukur. A e keni mendue ndonjëherë bukurinë e këtyne zaneve qi lëvizin nëpër buzët t’ona? Fjalët as nuk shifin as nuk preken, e pra kanë ma qendrim e konsistencë se na qi jemi mishit e gjakut. Para njëmijë, para dymijë vjetve kishte njerëz qi dojshin, mnijsin, urojshin namshin me shumicën e fjalve qi na sot përdorim, e më sa ata u shuen ne heshtjen ma të plotë, këto jetojnë e qarkullojnë e shërbejnë gjithënjë me shprehë dashunin, mënin, me ba urime e me hjedhë namë. Fjalët as nuk shifin, as nuk preken, por në ato asht drita e panjehun e syve qi nënqeshin tue i folë, dridhja e buzëve të njoma të rrudhuna qi i shqiptuene, loti e gazi i njëqind gjeneratave të sosuna. Ata sy e ato buzë u fikën e u ftofën, ai gaz u shue e ajo lode u tha, por fjalët shqipe fluturojnë gjithënjë gojë në gojë, gjatë shekujve, e këndojnë papushue ndër gëzime e qajnë papushue ndër mjerime, të pavdekshme, të përjetshme.”

Ndërsa për pasurinë e gjuhës shqipe Ernest Koliqi thotë:

“Dikush ankohet për vobeksin’ e gjuhës s’onë. Paragjykim, ky, qi duhet hjekë. Vërtetë qi shumë fjalë të jetës moderne e shum skaje kulturore i mungojnë shqipes, po edhe gjuhët e hueja këto i kanë marrun prej njana-tjetrës ose i kanë krijue. Shqiptari asht bulk, asht blegtuer: e ke një pasuni të çudiçme fjalësh e frazash mbi bujqësi e mbi blegtori dhe mbi sende, veprime e ndiesi qi përfshin jeta bujqësore e blegtorale.”²²⁰ Në shqyrtimin me titull “*Shprehjet e qytetit të Shkodrës*” Koliqi bën një sprovë vërtet interesante për të parë se deri në çfarë mase ishte përdorur në letërsinë e kohës e folmja qytetare, ndërsa më parë ai kishte filluar përmasat e gjera dhe vlerat e së folmes malësore që kishin ushtruar gjerë, sidomos Fishta e të tjerë, si dhe vetë Koliqi.

Shkrimtarët nga vise të ndryshme sjellin pasuri të çmueshme materiale lexikore e gramatikore, nga të folmet e palëvuara ose pak të lëvuara letrarisht, që shërbejnë jo vetëm për formësimin e paraqitjes artistike të veprave të tyre, por edhe për begatimin e mëtejshëm të visarit kombëtar leksikor e frazeologjik të gjuhës shqipe. Mund të thuhet që nuk ka më zona që të mos përfaqësohen në letërsi me shkrimtarë që kanë dalë së andejmi.

Dikur më të shquara kanë qenë qendrat më të mëdha qytetare si Shkodra, Elbasani, Korça dhe ngulimet e diasporës në italinë e Jugut e në Sicili. Pas Luftës së Dytë Botërore, krahas tyre, por me vrull edhe më të madh dhe si njësi gjithëpërfshirëse mbarëkombëtare, u zhvillua shumë jeta letrare artistike e kryeqytetit, Tiranës, ku u mblodhën shumë letrarë e njerëz të artit e të kulturës për të themeluar, mbajtur gjallë e zhvilluar më tej letërsinë dhe artet shqiptare. U zhvilluan shumë qendrat kulturore të qyteteve të reja, më parë të padëgjura ose edhe që nuk ishin fare si qendra qytetare. Ndërkaq, si kundërdihet, një zhvillim të përfillshëm do të merrte letërsia edhe në Kosovë e në hapësirat e tjera shqiptare jashtë Republikës së Shqipërisë. Me shumë rëndësi bëhet sidomos Prishtina, qendër e Universitetit dhe e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mjedis ku vepron teatri i gjuhës shqipe, ku dilnin dhe dalin shumë gazeta, ku veprojnë shumë radio e televizione dhe ku është përqëndruar një pjesë e madhe e figurave më të shquara të shkrimtarisë në gjuhën shqipe. Kështu, pamja e përgjithshme e gjeografisë letrare të autorëve të sotëm shqiptar na del me rreze shumë të shtrirë dhe, mbi të gjitha, si një lëvizje e shkallëzuar, hallkat e së cilës shkojnë jo vetëm nga krahinat drejt qyteteve e kryeqytetit, si një porces i natyrshëm e shprehës i zhvillimit e përparimit të trevave shqiptare në tërësi e veç e veç, po edhe në drejtim tjetër, d.m.th. nga kryeqyteti e qendrat e mëdha qytetare drejt krahinave, deri në zonat më pak të përfaqësuara në letërsi, siç janë ato të Shqipërisë Verilindore, të Malësisë së Madhe etj.

Përkatësia gjeografike e personazhëve është e lidhur, në radhë të parë me nevojën e njohjes së thellë të mjedisit ku lindin e rriten, ku rrojnë e punojnë, në mënyrë që në vepër ato të dalin sa më të gjalla e reale.

Në letërsinë shqiptare kemi një pamje të gjerë e të larmishme karakteresh që u përkasin mjediseve të ndryshme gjeografike dhe shoqërore: aty gjejmë malësorët e Veriut (në prozën e Koliqit, Migjenit, në poemat e Fishtës e Mjedës, në romanet e Haki Stërmillit), fshatarët e Jugut (në tregimet e Mitrush Kutelit, në prozën e Faik Konicës, në vjershat e Asdrenit dhe në shkrimtarinë më të re të gjysmës së dytë të shek. XX).

Bashkë me tematikën, natyrisht, vjen në letërsi edhe “era e të folurit” të vendlindjes së shkrimtarëve, vjen grigja e deleve, brazda dhe ugari, si dhe termat e rinj të mekanikës së përparuar, të elektronikës etj.

Por dendur krahas temave nga mjediset e njohura e të lidhura me zanafillën, poetët, shkrimtarët e dramaturgët e zgjerojnë këndin e vështrimit si dhe gjeografinë e mjedisin tematik të veprave të tyre, duke bërë objekt trajtimi edhe njerëz e ngjarje të viseve të ndryshme, ndonjëhere edhe shumë larg nga vendlindja e vendbanimi i tyre. Megjithatë, shkrimtari, edhe kur hyn në mjediset që s’i ka të vetat, duhet të njihet më mirë me to, të thithë prej tyre të veçantën dhe të përgjithshmen, zakonet, traditat dhe të folmen në mënyrë që tipat e përshkruar prej tij të

²²⁰ Ernest Koliqi, *Vepra 2, F.Konica*, Prishtinë, 2003, f.297-298.

jenë plot jetë dhe të jepen me vërtetësi e plotëri. Kjo bën që në letërsinë artistike të zhvillohet një proces i fortë kryqëzimi e ndërveprimi midis gjeografisë letrare të autorëve dhe gjeografisë letrare të personazheve. Autori ka vetëm një vendlindje, vetëm një të folme ose idiolect, kurse personazhet e tij janë të shumta dhe u përkasin viseve e mjediseve të ndryshme, d.m.th. kanë edhe të folme të ndryshme. Pasyrimi i këtyre të folmeve në letërsi do të bëhet me masë e me peshim pa rënë në mbartjen natyraliste të gjithçkaje që kanë të folmet popullore ose dialektet, por pa montime të sajara. E folmja e çdo personazhi duhet të jetë në përputhje me tipin që përfaqëson, me nivelin arsimor, me kulturën, konceptet, dëshirat dhe temperamentin e tij. Prandaj shkrimtari duhet të qëmtojë papushim në gurrën popullore, në gjuhën e folur të njerëzve të punës.

Një anë tjetër, ku shkrimtarët mund të gërmojnë më thellë për të sjellë në letërsi fjalët dhe shprehjen e gjallë të popullit, është frazeologjia popullore. Frazelogjizmat janë mjete të zhdërvjella, me vlera të mëdha emocionale, me ngjyrim të holla kuptimesh, me shprehësi të lartë, prandaj proza dhe drama janë fushat ku ndihet së tepërmi nevoja dhe efekti i tyre.

Njohja dhe përdorimi i frazeologjizmave nuk është kërkesë formale, por domosdoshmëri, që lidhet ngushtë me problemin ideor të veprës. Fakti që ato, përveç kuptimit leksikor, kanë edhe ngjyrim emocional, tregon se nëpërmjet tyre autori mund të shprehë më së miri edhe qëndrimin e vet ideoemocional.

Frazelogjizmat janë një nga mjetet gjuhësore që, pavarësisht se nga ç'krahinë burojnë, kur ndihet nevoja e tyre dhe përdoren me efekte të veta, mund të çajnë në gjuhë e mund të përgjithësohen.

PËRFUNDIMI

Ky punim përpiket t'i sjellë disa sinteza gjykimesh mbi ndikimin e letërsisë artistike në gjuhë dhe anasjelltas. Në të letërsia artistike trajtohet si ushqyese kryesore e gjuhësisë, e cila jo rrallë shmanget nga standardi (sidomos në rastet e poezisë lirike) vetëm e vetëm për të shprehur një efekt estetik dhe për t'iu larguar klisheve të zakonshme të stërpërdorura gjuhësore.

Në të trajtohen edhe shkrimtarë konkretë, jo vetëm për të ilustruar laryshinë dhe bukurinë e letërsisë sonë, por për të pasqyruar forcën e fjalës së bukur shqipe në format e ndryshme dhe në nuancat e llojllojshme kuptimore që merr ajo.

LITERATURA

1. Xhuvani, Aleksandër. "Vepra vëll. I", Tiranë, 1980
2. Kostallari, A. "Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë", Tiranë, 1984
3. Xhuvani, Aleksandër. "Mbi thjeshtësinë e gjuhës shqipe", Tiranë, 1973
4. Fishta, Gjergj. "Vepra letrare X", Lezhë, 2004
5. Bahtin, M. "Estetika e ligjëritimit krijues", Prishtinë, 1984
6. Koliqi, Ernest. "Vepra 5, Faik Konica", Prishtinë, 2003
7. "Fjalori i gjuhës së sotme shqipe", Tiranë, 1980
8. Çapaliku, S. "Prijës për gjeografinë dhe sociologjinë e letërsisë shqiptare", Tiranë, 1997